



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 14.07.2021, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Arbëreshë Kryeziu Hyseni, Fridon Lala, Agon Batusha, Arjeta Fejza, Shqipe Isufi, dhe Time Kadriaj.

Munguan: Driton Hyseni, Ardian Kastrati, Blerta Deliu Kodra dhe Branislav Nikoliq, ndërsa ishte i pranishëm edhe deputeti Dimal Basha.

I ftuar: Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.

Stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli dhe Safet Beqiri.

Mbledhjen e kryesoi, Rrezarta Krasniqi, kryetare e komisionit.

Kryetarja e komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 02.06.2021 dhe 16.06.2021;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-014 për ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”, i ftuar për ta prezantuar këtë Marrëveshje z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja, tha se është një propozim i deputetes Arbëresha Kryeziu-Hyseni lidhur me plotësimin e rendit të ditës. Propozoj që të plotësohet rendi i ditës me shtimin e pikës: *Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjetet, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.*

Pasi që rendi i ditës u hodh për votim me këtë propozim, votuan vetëm pesë anëtarë të Komisionit dhe ndërkohë mbledhjen e lëshoi deputetja Time Kadriaj. Mirëpo, në mbledhje arriti deputeti Fridon Lala dhe mbledhja e komisionit vazhdoi.

Arbëreshë Kryeziu -Hyseni, pas largimit të deputetes Time Kadriaj, kërkoi që të hiqet nga lista e nënshkrimeve ose të sillet një listë e re e nënshkrimeve dhe kjo të evidentohet në procesverbal, pasi që nuk është e mundur që kjo deputete të vije e të nënshkruhet dhe të lëshojë mbledhjen pas pesë minutash, sepse mbledhja është caktuar ditë më parë për mbajtjen e sotme dhe obligimet tjera janë të paarsyeshme dhe kërkoi që edhe një herë propozimi i saj të hidhet në votim.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshim dhe plotësim, me pikën e katërt: *Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjetet, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së*, e propozuar nga deputetja Arbëresha Kryeziu- Hyseni.

2. Miratimi procesverbalit nga mbledhja e datës 02.06.2021 dhe 16.06.2021;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës 02.06.2021 dhe 16.06.2021 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-014 për ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian” - i ftuar për ta prezantuar këtë Marrëveshje z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;

Kryetarja, falënderoi prezencën z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër, në mbledhjen e Komisionit për të paraqitur Marrëveshjen Financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër, falënderoi komisionin për mundësinë e dhënë që të paraqes Marrëveshjen Financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ai paraqiti ekipin e kabinetit të tij, i përbërë nga Kaltrina Zeka, shefe e kabinetit, Florim Canolli, dhe Artan Çollaku, nga Departamenti për Integrim Evropian. Marrëveshja e IPA 2020 është pjesë e programit të IPA II, dhe si e tillë është marrëveshja e fundit brenda saj, pas së cilës, nga Bashkimi Evropian do të fillojë programi i IPA III, e cila pritet të ketë kritere tjera dhe fokus të ndryshëm nga IPA II. Pjesa më e madhe e Marrëveshjes

së IPA 2020 është negociuar nga Qeveria Kurti I. Me datën 8 prill 2020 është marrë vendimi për nisjen e negociatave, ndërsa përfundimi i saj ka ndodhur gjatë muajit gusht të vitit 2020. Në këtë vit Bashkimi Evropian ka kërkuar që të shqyrtohen alokimet e mjeteve duke i përshtatur me rrethanat e krijuara me pandeminë gjatë vitit 2020 dhe emergjencën ekonomike si rezultat i pandemisë. Pasi që pjesa e parë e kësaj marrëveshje veç se është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës më 8 tetor 2020.

Në tërësi fondi i IPA 2020 është 90.2 milionë euro, duke i bashkangjitur pastaj dhe grantet e tjera nga institucionet financiare ndërkombëtare, sikurse: Wiederaufbau me 13 milionë euro, GIZ gjerman me 300 mijë euro, dhe nga UNICEF me 300 mijë euro. Në pikëpamje sektoriale shuma prej 90.2 milionë euro është ndarë në pesë sektorë: në demokraci dhe qeverisje; sundim të ligjit dhe të drejtat fundamentale; mjedis, veprim klimatik dhe energji; konkurrenca, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural; dhe arsimit, punësimi dhe politikat sociale.

Të pjesa e parë demokraci dhe qeverisje, pjesa më e madhe ka të bëjë me menaxhimin e pandemisë dhe ka rezervën e pa alokuar, e cila mund të përdoret për luftimin e pasojave të pandemisë, në një shumë prej 10.6 milionë euro. Ndërsa pjesa e dytë brenda këtij sektori, është rreth gjysmë milion euro dhe ka të bëjë me pagesën e anëtarësisë së Kosovës në programet e Bashkimit Evropian, siç janë “Erasmus +”, “Evropa kreative”, “Evropa për qytetarët”, “Cosme”, “Ficalis” dhe “Dogana”.

Sektori i sundimit të ligjit dhe të drejtat fundamentale, ka një vlerë prej 10.3 milionë euro, ku 0.3 milion euro janë bashkëfinancim, ndërsa 10 milionë euro janë grante, e cila pastaj alokohet në tri komponenta, të cilat kanë të bëjë me trajtimin e fëmijëve lypsarë dhe kthimin e tyre në shkollë. Një pjesë e madhe ka të bëjë për drejtësi dhe një pjesë tjetër për reformat në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ndërsa, pjesa më e fuqishme financiare ka të bëjë me sektorin e mjedisit dhe ndryshimeve të klimës. Në këtë sektor janë alokuar gjithsej mbi 53 milionë euro. Kryesisht ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të mbeturinave, 16 milionë euro të BE-së dhe 13 milionë euro grante nga Banka Zhvillimore e Gjermanisë.

Kurse në sektorin e konkurrencës dhe inovacionit, janë disa projekte, siç janë në sektorin e ujitëses, me 10 milionë euro, projekti për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve me 1.5 milion euro, si dhe për pemëtarinë dhe vreshtarinë, rreth 800 mijë euro.

Projekti i tretë ka të bëjë me turizmin dhe trashëgimin kulturore, në tërësi prej 6.4 milion euro, projekte të cilat kanë të bëjnë me Janjevën, Prizrenin dhe Ulpianën.

E fundit është përkrahja për bizneset me qëllim të lehtësimit të pasojave të tyre me Covid-19, në vlerën e 5.5 milion euro. Dhe përkrahja e punësimit që është me 1 milion euro, që kryesisht ka të bëjë me asistencë për Ministrinë e Mirëqenies Sociale, si dhe përkrahja për arsimin e lartë. Në total nga viti 2014, Kosova është dashur të përfitojë nga IPA II me 646 milionë euro, mirëpo kjo shumë gjatë viteve ka pësuar rënie për arsye se Kosova nuk ka arritur t'i përmbushë disa obligime në raport me Bashkimin Evropian. Shembull në vitin 2018, shuma e përfitimeve ka rënë nga 645 milionë, në 602 milionë, do të thotë janë humbur 43 milionë. Ndërsa, për herë të fundit në vitin 2019, janë shkurtuar rreth 12 milionë euro, të cilat kanë qenë të zotuar dhe janë humbur për shkak se nuk është gjetur lokacioni i ndërtimit të objektit për magazinimin e mbeturinave të rrezikshme, e cila ka qenë pjesë e IPA 2015.

Kryetarja, pas prezantimit, propozoi të bëhet një amendament në këtë projektligj, pra:

Amendamenti 1

Në titullin e projektligjit fjala “Projektligji” të zëvendësohet me fjalën “Ligji”, të cilin e hodhi ne votim.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe asnjë kundër, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Projektligji nr. 08/L-014 për ratifikimin e “Marrëveshjes Financiare për IPA 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian”, me Amendamentin 1, si: Në titullin e projektligjit fjala “Projektligji” të zëvendësohet me fjalën “Ligji”, si dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim.

Kryetarja, pyeti zëvendëskryeministrin Bislimi, rreth deklaratave të pamatura të ministres Gërvalla, nëse ato deklaratat janë në harmoni me qëndrimet e Qeverisë së Kosovës apo janë qëndrime personale të ministres. Pra deklarimet e bëra në mbështetje të Bashkimit Evropian, duke thënë se Kosova, ende nuk i ka përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër, e falënderoi Komisionin për mbështetjen e projektligjit, kurse sa i përket pyetjes rreth deklaratave të ministres Gërvalla, u shpreh se pse kualifikohen si të pamatura, pasi që sipas tij nuk mund të kualifikohen deklaratat e tillë. BE-ja është mike e Kosovës dhe kjo e fundit është konfirmim se Kosova ka marrëdhënie të mira me BE-në. Ndërsa sa i përket kushteve për liberalizimin e vizave është fakt se kushtet teknike Kosova i ka përmbushur që nga viti 2018, e që është qëndrim i të gjitha agjencive brenda BE-së, pra institucioneve të saj. Problemi i vetëm është votimi në Këshillin e BE-së, ku secili shtet anëtar ka fuqinë e vetë. Dy shtetet të paktën janë hezituese në mbështetjen e Kosovës në liberalizimin e vizave, ato janë: Franca dhe Holanda. Brengat e tyre janë kryesisht me zbatimin në praktikë të sundimit të ligjit. Kjo ka qenë arsye e vizitës së ministrit të Punëve të Brendshme z. Sfeçla në Paris në fund të muajit qershor dhe angazhimeve që ka me Ministrinë e Punëve të Brendshme atje, me qëllim të bindjes së Francës për progresin e arritur të Kosovës në luftimin e krimit dhe korrupsionit.

Deklarimet e ministres Gërvalla, i sheh në kontekst se brenda BE-së ka vende që ende besojnë që Kosova nuk ka shënuar progres të mjaftueshëm.

U pajtua se, në BE askush nuk e konteston se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave e nuk ka kriter shtesë nga BE-ja, por ka vetëm kërkesa nga vendet anëtare që Kosova të dëshmojë më shumë progresin në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kryetarja, po ashtu pyeti se a ka Qeveria e Kosovës një strategji për të bindur dy vendet që janë kundër liberalizimit të vizave, siç është Franca dhe Holanda. Gjithashtu pyeti rreth takimit të paralajmëruar të kryeministrit të Kosovës në Bruksel më 19 korrik 2021, cila është

platforma apo strategjia e këtij takimi, si dhe pyeti për takimin e zëvendëskryeministrit të realizuar ditë më parë në Bruksel, sepse nuk ka pasur shumë transparencë për çështjen e dialogut dhe do të ishte mirë që të raportohet për të në Kuvend ose në Komision. Deklaratat e tilla informuese, për këtë takim janë bërë vetëm në rrjetet sociale, rreth çështjes së dialogut të javës së kaluar.

Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër, tha se sinjalizimi i tyre është në disfavor dhe kështu kanë pamundësuar që ky proces të futet në agjendën e Këshillit. Po ashtu, tha se përveç tij, janë të përfshirë edhe bartësit e institucioneve tjera, siç është Presidentja, Kryeministri, ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Punëve të Brendshme. Aktualisht angazhimi më i madh është duke u bërë nga ministri i Punëve të Brendshme dhe ministri i Punëve të Jashtme me shtetet skeptike, por edhe me shtetet tjera potenciale që mund të jenë kundër, siç është rasti i Belgjikës. Po ashtu, ka treguar për takimet e realizuara në shtetet si Belgjika dhe Luksemburgu, lidhur me çështjen e liberalizimit të vizave.

Rreth raportimit u shpreh se pas takimit të parë në Bruksel, ka raportuar në Komisionin për Politikë të Jashtme dhe ka marrë pjesë në debatin e zhvilluar në Kuvend. Bislimi përmendi shkresën e dërguar për të gjithë liderët politikë në Kosovë dhe institucioneve të Kosovës, duke i informuar rreth ecurisë së takimeve të para në dialog në Bruksel. Qeveria e Kosovës nuk duhet të bëjë publike strategjinë për bisedime me palën serbe, që ata të jenë të përgatitur me informatat në takimet e dialogut.

Lidhur me raportimin pas kthimit nga Brukseli, tha se nuk ka pasur ftesë për të raportuar në asnjë prej komisioneve parlamentare. Qëllimi është që në Bruksel të nxjerrin marrëveshje të mira dhe takimi i javës së kaluar atje, ka qenë për raportim për zbatimin e marrëveshjeve të arritura deri me tani, si dhe brengat e secilës prej palëve. Qeveria e Kosovës u deklarua se prej njëmbëdhjetë marrëveshjeve, Serbia nuk i ka zbatuar obligimet e saj. BE-ja është pajtuar se nuk janë zbatuar nga Serbia këto marrëveshje, ndërsa sa i përket marrëveshjes për veturat. BE-ja ka thënë se Kosova nuk i ka përmbushur komplet obligimet e saj për arsye se ka qenë një periudhë e cila është dashur të përfundojë më 15 shtator 2021, për vlefshmërinë e tabelave KS. Ndërkaq me vendim të Qeverisë, në shtatorin e vitit të kaluar është ndërprerë shtypja e tabelave KS dhe nga Qeveria e Kosovës është shpjeguar se tabelat në Kosovë kanë një vlefshmëri prej një viti dhe pas kësaj periudhe është dhënë sinjali se Kosova nuk është më e interesuar që të vazhdojë më me këtë marrëveshje, përtej datës 15 shtator 2021.

Takimi i javës së kaluar në Bruksel, ka qenë vetëm për të raportuar lidhur me marrëveshjet e deritanishme dhe nuk ka pasur hapje të temave të reja. Ndërsa, pas takimit të datës 19 korrik 2021, do të njoftohen liderët politikë dhe institucionet rreth temave që do të hapen në Bruksel.

Bislimi, ndërkohë njoftoi se z. Andin Hoti, është emëruar kryetar i Komisionit për Personat e Pagjetur, kurse shtoi nuk është në rregull të thuhet se ka pasur zero transparencë, pasi që për shkak të gjendjes shëndetësore dhe ishte i sëmur, ai erdhi në Komision nga klinika.

4. Shqyrtimi i Projektligjin nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjetet, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja, tha se çështjet e rregulluara dhe të trajtuara nga ky projektligj kanë të bëjnë me heqjen e detyrimit të homologimit të automjeteve rrugore, të reja dhe të përdorura, duke shtuar këtë kategori tek mjetet rrugore që janë të përjashtuara nga ky detyrim, në nenin 9 të Ligjit bazik. Çështjet e rregulluara me këtë projektligj dhe amendamentet e Komisionit funksional, nuk janë të mbuluara në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së dhe si të tilla nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së, prandaj si Komision mund t'i rekomandojmë për miratim të mëtejme.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe asnjë votë kundër, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit Funksional për Projektligjin nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjetet.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Rrezarta Krasniqi, kryetare, tha se çështjet e trajtuara nga ky projektligj kanë të bëjnë me evitimin e të metave dhe problemeve të hasura në praktikë, lidhur me zhvillimin e procedurës disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë, përkatësisht lidhur me shqiptimin e suspendimit për gjyqtarë dhe prokurorë. Lidhur me këtë projektligj nuk kishte ndonjë amendament nga ana e Komisionit Funksional. Ndërsa çështjet e adresuara me këtë projektligj nuk janë të rregulluara me legjislacion të BE-së. Andaj, si Komision mund të rekomandojmë për miratim të mëtejme.

Kryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë vota për dhe asnjë votë kundër, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-003 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6. Të ndryshme.

Për këtë pikë, kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me:

a) Vizita në Komuna

Lidhur me organizimin e vizitave në Komuna, pyeti nëse ka propozime për organizimin e ndonjë vizitë të radhës gjatë këtij muaji dhe për datën e saj. Në Komision u vendos që vizita e radhës të realizohet në Komunën e Prizrenit, me datën 27 korrik 2021.

b) Takimi me shoqërinë civile

Kryetarja, kërkoi nga anëtarët e Komisionit nëse pajtohen që të organizohet një takim i radhës me përfaqësuesit e shoqërisë civile gjatë këtij muajit me qëllim të diskutimit, fillimin e bashkëpunimit me ta dhe mundësisë së organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim të komunikimit në procesin e integritit evropian.

Arbreshë Kryeziu-Hyseni, tha se mund të organizohet takimi javën e ardhshme dhe të shkohet me listën e OJQ-ve që ka Komisioni aktualisht, dhe nëse ka ndonjë propozim nga anëtarët e Komisionit të ndonjë OJQ-je e cila mund të ketë arsye të ftohet, mund t'i bashkëngjitet kësaj liste gjatë javës. Ajo kërkoi që mbledhjet e Komisionit të mbahen çdo të mërkure, përveç atëherë kur nuk ka çështje për takime, pra të organizohen takimet e rregullta javore në përputhje me planin e punës dhe rregulloren.

Kryetarja tha, pra Komisioni vendosi që më 21 korrik 2021 të organizohet takimi i përbashkët me përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim të bashkëpunimit dhe komunikimit në procesin e integritit evropian të Kosovës.

c) Ftesë për delegacionin e Kroacisë

Rrezarta Krasniqi, kryetare e njoftoi Komisionin se ka dërguar një ftesë për Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit të Kroacisë për të realizuar një vizitë në Kosovë, pas interesimit të tyre për të pasur takim me këtë Komision, do të thotë kanë shprehur gatishmërinë për vizitë në Kosovë. Takimi planifikohet të organizohet në fund të muajit shtator apo në fillim të muajit tetor, mirëpo pas konfirmimit të tyre do të njoftoheni me kohë.

d) Ftesë për Ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë

Kryetarja, propozoi që pasi Sllovenia tashmë e ka marrë kryesimin e Këshillit të Bashkimit Evropian, të ftohet Ambasadori i Sllovenisë në Kosovë, për tu njoftuar lidhur me prioritetet e Presidencës Sllovene. Data e takimit do të varet nga mundësia e Ambasadorit dhe koha që ka ai në dispozicion.

Agon Batusha, komentoi mungesën e përfaqësuesve të opozitës në mbledhjen e Komisionit, reagimi ndaj rastit të deputetes që e lëshoi takimin, siç tha pas pesë minutave pasi u nënshkrua në listën e anëtarëve të Komisionit, me arsyetim se është mbledhje formale. Komisioni shqyrtoi tri projektligje, njëra ku Kosova përfiton 90 milionë euro dhe dy të tjera që kanë të bëjnë me reformën në gjyqësor dhe tjetra me homologim, që prek drejtpërdrejt interesat e qytetarëve. Duhet të bisedohet me përfaqësuesit e opozitës që të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit dhe të mos bëjnë pengesa, ku përfitojnë qytetarët e Kosovës, sidomos kur bëhet fjalë për përfitimet milionëshe nga ana e Bashkimit Evropian.

Rrezarta Krasniqi, kryetare, bëri të ditur se Komisioni do të dërgoj një kërkesë për pjesëmarrje në takim in e radhës për Konferencën e Komisioneve Parlamentare për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parla menteve të BE-së (COSAC) nëse është e mundur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

**Rrezarta Krasniqi,
Kryetare e Komisionit**
